

MUHAMED XHEMIL ZEJNO

**MËSOJE BESIMIN  
NGA KURANI  
DHE SUNETI**



# Mësoje Besimin nga Kurani dhe Suneti

Titulli i origjinalit:

خذ عقيدتك من الكتاب والسنة الصحيحة

Përmbledhi dhe shkroi:

**Muhamed Xhemil Zejno**

*(Allahu e mëshiroftë!)*

Profesor në “Darul-Hadith” - Meke

Përshtati nga arabishtja:

**Bashkim Selmani**

Recensoi:

**Edmond Ajdini**

Faqosja dhe kopertina:

**Pelegrini**



## PARATHËNIE

### *Me Emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Falënderimi i përket vetëm Allahut dhe vetëm Atë e falënderojmë. Prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. E lusim Allahun e Lartësuar të na mbrojë prej të këqiave të igurt tona dhe prej të këqiave të veprave tona. Atë që e udhëzon Allahu në rrugë të drejtë, askush nuk mund ta devijojë dhe atë që Allahu e lë në humbje, askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk e meriton adhurimin askush tjetër përveç Allahut, të Vetmit, i Cili nuk ka të ngjashëm e as ortak dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! -.

### **E si vijon:**

Në këtë libër do të përmbledhim disa pyetje të rëndësishme në lidhje me besimin që duhet të ketë muslimani, pyetje të cilave u është dhënë përgjigje nëpërmjet argumentave prej fjalëve të Allahut nga Kurani dhe fjalëve të Pejgamberit –Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi

të! – nga suneti profetik, në mënyrë që lexuesi të ndihet i sigurtë për përgjigjen e saktë, ngase veçimi i Allahut në besim, është themeli i lumturisë së njeriut në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. E lus Allahun që ky botim të jetë sa më dobiprurës për muslimanët dhe fëmijët e muslimanëve, si dhe të jetë një vepër e sinqertë, për të fituar vetëm kënaqësinë e Allahut të Lartësuar!

**Muhamed Xhemil Zejno**

*(Allahu e mëshiroftë!)*





## FJALA E PËRKTHYESIT

Falënderimi i takon Allahut! Me mirësinë e tij fillohet dhe përmbushet çdo vepër. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij -sal-lAllahu alejhi ve sel-lem!- familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që e ndjekin dhe do ta ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Nisur nga nevoja e shoqërisë tonë për një libër të përmbledhur ku të renditen në të shkurtimisht disa nga çështjet kryesore që kanë të bëjnë me akiden dhe kuptimin e duhur të fesë së Allahut sipas rrugës dhe mënyrës që na e ka lënë trashëgimi i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij -sal-lAllahu alejhi ve sel-lem!-, e pashë të arsyeshme që të sjell për lexuesit, këtë punim akademik e të mirëstudiuar të profesorit të njohur **Muhamed Xhemil Zejno**, për t'u ardhur sadopak në ndihmë muslimanëve të rinj dhe hoxhallarëve që punojnë me ta, dhe si një lehtësim për ta në mbajtjen e mësimëve, kurseve apo këshillave të shkurtra.

Gjatë përkthimit të këtij libri e kam parë të nevojshme që t'i bëj një renditje tjetër temave të tekstit të shejhut, në

atë mënyrë që ato të vinin si një tekst i vetëm, ku pyetjet të kishin lidhje me përgjigjet e mëparshme, pa ndryshuar asgjë nga materjali i shejhut, përveç kur e kam parë të nevojshme që për efekt qartësimi të bëj sqarimin e tekstit me përdorimin e kllapave, me qëllim që lexuesit të mos i zbehet dëshira dhe t'i vështirësohet leximi.

Duke e falënderuar Allahun në fillim dhe në fund, e lus Allahun që përkthimin dhe botimin e këtij libri ta pranojë si një vepër që me të kërkohet vetëm kënaqësia e Tij, salavatet dhe selamet më të përzemërta qofshin mbi të Dërguarin e Fundit – Muhamedin –sal-!Allahu alejhi ve sel-lem!-, familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që e ndjekin dhe do ta ndjekin atë deri në Ditën e Gjykimit!

**Bashkim Selmani**

E enjte - 11.03.2021





**E DREJTA E ALLAHUT  
MBI ROBËRIT**

*(E DREJTA TË CILËN AI DO  
TA KËRKOJË PREJ TYRE)*

**ADHURIMI VETËM I TIJ**









### **Pyetja e 1-rë: Përse na ka krijuar Allahu?**

**Përgjigja:** Allahu na ka krijuar që ta adhurojmë vetëm Atë dhe të mos e barazojmë dhe krahasojmë Atë me asnjë dhe asgjë tjetër.

Argumeti në lidhje me këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾ [الذاريات:56]

﴿**Dhe se (Unë) nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për diçka tjetër, veçse për të më adhuruar (vetëm Mua).**﴾

(edh-Dharijat:56).

...si dhe fjala e të Dërguarit të Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! –:

«حق الله على العباد أن يعبدوه ولا يشركوا به شيئا»

«**E drejta e Allahut mbi robërit (të cilën Ai do ta kërkojë prej tyre), është që ata ta adhurojnë (e madhërojnë) vetëm Atë dhe me Të të mos e barazojnë asnjë tjetër.**» (Mutefekun alejhi)

## Pyetja e 2-të: Ç'kuptojmë me fjalën *adhurim* (*ibadet*)?

**Përgjigja:** Termi “adhurim” përmbledh çdo gjë që e dëshiron Allahu i Lartësuar, qoftë ajo fjalë apo vepër, si: lutje, namaz, kurban, e të tjera si këto, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾ [الأنعام: ١٦٢]

﴿**Thuaj: Namazi im, kurban im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun - Zotin e botëve.**﴾

(el-En'am:162)

Fjala “**kurban im**”:  
nënkupton “therjën e kafshëve që Allahu i ka konsideruar të lejuara për t'u ngrënë”. Po ashtu, i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«وما تقرب عبدي إلي بشيء أحب إلي مما افترضته عليه»

«*Allahu i Lartësuar ka thënë: “Nuk afrohet rob i Im tek Unë me diçka më të dashur për Mua sesa me kryerjen e obligimeve të cilat Unë ia kam obliguar atij...”*» (Buhariu: hadith kudsij)



### Pyetja e 3-të: Si duhet ta adhurojmë Allahun?

**Përgjigjja:** Ne e adhurojmë Allahun vetëm ashtu siç Ai dhe i Dërguari i Tij – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – na e kanë mësuar, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar i Cili ka thënë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَلَا تُبْطِلُوا أَعْمَالَكُمْ﴾

[محمد: ٣٣]

﴿**O ju që keni besuar! Ndiqeni Allahun** (në çfarë ju ka porositur) **dhe ndiqeni të Dërguarin** (në çfarë ju ka mësuar), **dhe mos i çoni dëm punët** (duke vepruar sipas dëshirave) **tuaja.**﴾ (Muhamed:33)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – në lidhje me këtë ka thënë:

«من عمل عملاً ليس عليه أمرنا فهو رد»

«**Kush vepron një vepër që nuk është në përputhje me mësimet tona, ajo është e refuzuar**» (Muslimi)

Fjala “**e refuzuar**” nënkupton se ajo vepër “nuk është e pranuar” tek Allahu.



## **Pyetja e 4-tërt: Si mund të arrihet një adhurim i përkryer?**

**Përgjigja:** Përkryeshmëria në adhurim arrihet duke e ndierë mbikqyrjen e Allahut gjatë adhurimit, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَتَوَكَّلْ عَلَى الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ الَّذِي يَرَاكَ حِينَ تَقُومُ وَتَقَلُّبِكَ فِي السَّاجِدِينَ﴾

[الشعراء: ٢١٧-٢١٩]

﴿E ti mbështetju të Plotfuqishmit, Mëshirëplotit, i Cili të shikon ty sa herë që ngrihesh (në namaz) dhe kur të biesh në sexhde me ata që bien.﴾ (esh-Shuara:217-219)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«الإحسان أن تعبد الله كأنك تراه، فإن لم تكن تراه فإنه يراك»

«Përkryeshmëria është që ta adhurosh Allahun sikur ta shihje Atë. Edhe pse ti nuk e sheh Atë, të sheh Ai ty.» (Muslimi)



## Pyetja e 5-të: A është e mundur, edhe ta kemi frikë Allahun edhe ta duam?

**Përgjigja:** Po, madje Allahu duhet adhuruar edhe me drojë edhe me shpresë, ashtu siç e ka përshekruar Allahu i Lartësuar adhurimin e besimtarëve të singertë, duke thënë:

﴿يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ﴾ [السجدة: ١٦]

﴿...e adhurojnë Zotin e tyre me frikërespekt dhe me shpresë, dhe se nga pasuria me të cilën Ne i kemi furnizuar ata japin (për njerëzit në nevojë).﴾ (es-Sexhde:16)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«أسأل الله الجنة، وأعوذ به من النار»

« E lus Allahun që të më bëjë prej banorëve të Xhennetit dhe i kërktoj Allahut të më mbrojë nga Zjarri (i Xhehenemit)!»

(Ebu Daudi: Sahih)







**TEUHIDI**  
**VEÇIMI I ALLAHUT**  
**NË ADHURIM DHE**  
**RËNDËSIA E TIJ**









## Pyetja e 1-rë: Përse Allahu i dërgoi profetët?

**Përgjigjja:** Allahu i Lartësuar i dërgoi profetët që ata t'i ftonin njerëzit ta njihnin dhe adhuronin vetëm Allahun, si dhe të hiqnin dorë nga idhujtaria, ashtu siç Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ﴾ [النحل: 36]

﴿Në çdo popull Ne kemi dërguar pejgamberë që (t'u thonë:) të adhuronin Allahun dhe t'i largoheni tagutit<sup>(1)</sup>﴾ (en-Nahl:36)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«الأنبياء إخوة، ودينهم واحد»

«Profetët janë vëllezër, ndërsa feja e tyre është një (pra, është Teuhidi).»

---

<sup>1</sup> Fjala “tagut” (devijues) nënkupton djallin që fton në adhurimin e diçkaje apo dikujt tjetër përveç Allahut ose nënkupton çdokë që pëlqen të madhërohet dhe të adhurohet në vend të Allahut.

**Pyetja e 2-të: Cilat janë mirësitë e teuhidit (veçimit të Allahut në adhurim)?**

**Përgjigja:** Mirësia kryesore e teuhidit, pra veçimit të Allahut në adhurim, është gjetja e udhëzimit në jetën e kësaj bote, fshirja e gjynaheve, arritja e sigurisë në botën tjetër, si dhe shpëtimi prej dënimit, ashtu siç Allahu i Lartësuar ka thënë në Librin e Tij - Kuran:

﴿الَّذِينَ آمَنُوا وَلَمْ يَلْبِسُوا إِيمَانَهُمْ بِظُلْمٍ أُولَٰئِكَ لَهُمُ الْأَمْنُ وَهُمْ مُهْتَدُونَ﴾  
[الأنعام: ٨٢]

﴿Sa u përket atyre që besuan dhe besimin e tyre nuk e veshën me padrejtësi (pra, me idhujtari), të tillëve do t'u përkasë siguria (në botën tjetër) dhe pikërisht të tillët janë të udhëzuar (në të vërtetën)﴾! (el-En'am:82).

Fjala ﴿...nuk e veshën me padrejtësi...﴾ tregon se: Besimi i tyre i brendshëm në Allahun e Lartësuar nuk vishet me vepra të jashtme idhujtarie.

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«وَحَقَّ الْعِبَادَ عَلَى اللَّهِ أَنْ لَا يَعْذِبَ مَنْ لَا يَشْرِكُ بِهِ شَيْئاً»

«Ndërsa e drejta e robërve (që ata kanë të drejtë ta kërkojnë) tek Allahu është: që Ai të mos e dënojë (në botën tjetër) asnjë që nuk i ka bërë Atij shirk (idhujtari) asgjë.» (Mutefekun alejhi)



**Pyetja e 3-të: Ç'është Teuhidi Rububije** (*veçimi i Allahut në zotërim*)?

**Përgjigja:** Teuhidi rububije është të besuarit se Allahu është i veçuar nga krijesat në veprat e Tij, që do të thotë se askush nuk ka bërë dhe as nuk mund të bëjë veprat e tij, qoftë në krijim, qoftë në zotërim, drejtim..etj. ashtu siç Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾ [الفاتحة: ٢]

﴿**Falënderuar qoftë Allahu - Zoti i botëve** (*i gjithë krijesave*)!﴾ (el-Fatiha:1)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mi të! – kur lutej thoshte:

«أنت رب السموات والارض»

«(O Allahu im! Vetëm) **Ti je Zoti i qiejve dhe i tokës!**»  
(Mutefekun alejhi)



**Pyetja e 4-tërt: Ç'është Teuhidi Uluhije** (*veçimi i Allahut në adhurim*)?

**Përgjigja:** Teuhidi uluhije është besimi se Allahu është i veçuar nga krijesat në adhurim, që do të thotë se vetëm Atij i duhen kushtuar adhurimet, si: lutjet, kurbanet, zotimet..etj. siç ka thënë Allahu i Latësuar në Kuran:

﴿وَالْهَيْكُمُ إِلَهٌُ وَاحِدٌ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ﴾ [البقرة: ١٦٣]

﴿...dhe (*dijeni*) se **Zoti juaj është Zoti i Vetëm. Nuk ka zot tjetër** (*që e meriton adhurimin*) **veç Tij. Ai është i Gjithmëshirshmi, Mëshirëploti!**﴾ (el-Bekare:163)

﴿فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا﴾ [الكهف: ١١٠]

﴿**E kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të dobishme, dhe të mos i bëjë shirk** (*ortak*) **në adhurim Zotit të vet asnjë.**﴾ (el-Kehf:110)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«فليكن أول ماتدعوهم إليه، شهادة أن لا إله إلا الله»

«**Le të jetë gjëja e parë në të cilën t'i ftosh ata, dëshmia La ilahe il'la Allah** – (*Nuk ka zot tjetër që e meriton adhurimin përveç Allahut*)»<sup>(2)</sup>. E në një transmetim tjetër tek Buhariu është: «...**derisa ata ta veçojnë Allahun** (*në adhurim*)!»

<sup>2</sup> Mutefekun alejhi

**Pyetja e 5-të: Ç’është Teuhidi Esmā’ ue Sifat** (veçimi i Allahut në raport me emrat dhe cilësitë e Tij)?

**Përgjigja:** Teuhidi esmā’ ue sifāt është besimi se Allahu është i veçuar nga krijesat në raport me emrat dhe cilësitë e Tij, që do të thotë se askush nuk i ka emrat dhe cilësitë e Tij, të cilat duhen pranuar dhe pohuar ato ashtu siç Ai e ka emërtuar dhe cilësuar Vetën e Tij në Kuran apo e ka emërtuar dhe cilësuar me to i Dërguari i Tij – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – në hadithet autentike.

Kështu ne i pranojmë dhe i pohojmë ato siç kanë ardhur, pa ua tjetërsuar kuptimin, pa ua mohuar atë, pa i ngjasuar ato me cilësitë e krijesave, si dhe pa ua refuzuar kuptimin. Pra: “**Istiwa**-ja (Ngritja dhe qëndrimi mbi Arsh)”, “**Nuzul**-i (Zbritja në qiellin e dynjasë në një të tretën e natës)”, “**Jed**-i (Dora e Tij)”...e të tjera si këto, ne i besojmë ashtu siç i përshtaten madhësisë dhe përsosmërisë së Allahut të Lartësuar, sipas rregullit që na e ka mësuar:

﴿لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ﴾ [الشورى: 11]

﴿**Asgjë nuk është i ngjashëm me Të, e Ai është Dëgjuesi, Shikuesi!**﴾ (esh-Shura:11)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«ينزل الله في كل ليلة إلى السماء الدنيا»

«**Allahu zbret çdo natë** (në një të tretën e saj) **në qiellin e kësaj bote..**» (Muslimi)

Fjala “**zbret**” nënkupton atë zbritje që i përshtatet Madhësisë së Tij, pa e përngjasuar atë me asnjë zbritje të krijesave të Tij.



## Pyetja e 6-të: Ku ndodhet Allahu?

**Përgjigjja:** Allahu është mbi **Arsh** (*mbi Fronin e Tij*) i cili është përmbi qiejtë e lartë, siç Ai ka thënë në Kuran:

﴿الرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوَى﴾ [طه: ٥]

﴿**I Gjithmëshirshmi** (është) **përmbi Arsh** (*mbi të cilin*) **u lartësua**.﴾ (Taha:5) që nënkupton se Ai “*u ngrit dhe u lartësua përmbi Arsh*” ashtu siç është përmendur dhe te Buhariu, ku Pejgamberi – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«إن الله كتب كتاباً...فهو عنده فوق العرش»

«*Allahu shkroi një shkresë, e cila gjendet tek Ai përmbi Arsh.*» (Mutefekun alejhi)



## Pyetja e 7-të: A është Allahu prezent me ne?

**Përgjigjja:** Po. Allahu është prezent me ne dhe në çdo çast Ai na shoqëron ne me dëgjimin, shikimin dhe me dijen e Tij, ashtu siç Ai ka thënë në Kuran:

﴿قَالَ لَا تَخَافَا إِنِّي مَعَكُمَا أَسْمَعُ وَأَرَى﴾ [طه: 46]

﴿ (Allahu i) **tha** (Musait dhe Harunit): **Mos kini frikë, pasi me të vërtetë Unë jam me ju, dëgjoj dhe shikoj (gjithçka)!** ﴾(Taha:46)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«إِنكُمْ تَدْعُونَ سَمِيعاً قَرِيباً وَهُوَ مَعَكُمْ»

«**Ju po i luteni Atij që është Dëgjues, i Afërt dhe që është me ju!**»<sup>(3)</sup> pra, me dijen dhe me përkujdesin e Tij.




---

<sup>3</sup>Muslimi



**Pyetja e 8-të: Si ta largojmë cytjen e shejtanit, nëse na vjen me pyetjen: “Po Allahun kush e krijoi?”**<sup>4)</sup>

**Përgjigja:** Nëse ndonjërit shejtani ia pëshpërit në mendjen e tij këtë pyetje, atëherë ai të kërkojë mbrojtjen e Allahut, ashtu siç Ai na ka porositur:

﴿وَأَمَّا يَنْزَغَنَّكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نَزْعٌ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ﴾  
[فصلت: 36]

﴿E nëse të vjen ty ndonjë ngacmim prej shejtanit, atëherë kërkoji mbrojtje Allahut, pasi vërtet Ai është Dëgjuesi (i lutjes), i Dijshmi (për çdo gjë).﴾ (Fusilet:36)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – na tregojnë se si t’ia prishim këtë kurth shejtanit, duke thënë:

«**Thoni: Unë i besoj Allahut dhe të Dërguarit të Tij** (me besim të palëkundur). **Allahu është Ehad** (Një e i Vetëm si askush që ne njohim). **Allahu është Samed** (i Vetëmjaftueshmi, që të gjithë kanë nevojë për Të dhe Ai s’ka nevojë për asnjë). **Ai nuk ka lindur asnjë e as nuk ka lindur prej askujt, dhe se me Të nuk është i njëjtë askush.**» Pastaj të pështyjë tre herë nga e majta e vet, dhe të kërkojë mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar me fjalët: “**Eudhu bilahi mineshejtani rraxhijm**”

---

<sup>4</sup> Kjo pyetje është një hile e shejtanit për ta bërë njeriun që ta peshojë të vërtetën e Allahut me peshoren e krijesave, por e vërteta është se askush nuk është si Allahu.

*(I lutem Allahut të më mbrojë prej shejtanit të mallkuar!) e të mos i japë rëndësi këtij dyshimi<sup>5</sup> dhe Allahu ka për ta mbrojtur nga ky ngacmim i shejtanit.*



---

<sup>5</sup> Ky dyshim edhe logjikisht është i dobët, pasi kemi të bëjmë me një pyetje imponuese që e konsideron Allahun të krijuar, ndërkaq Allahu nuk është i krijuar por është vetë Krijuesi, dhe se gjithçka tjetër është e krijim i Tij, ngase Ai është i Pari pa fillim dhe i fundit pa mbarim (sh.p).



# SHIRKU I MADH

(IDHUJTARIA QË  
TË NXJERR NGA BESIMI)







## Pyetja e 1-rë: Cili është gjynahu më i madh tek Allahu i Lartësuar?

**Përgjigja:** Gjynahu më i madh tek Allahu i Lartësuar është **shirku** (*idhujtaria*) që nënkupton adhurimin dhe madhërimin e dikujt tjetri krahas Allahut, siç ka thënë në Kuran:

﴿وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ﴾  
[لقمان: ١٣]

﴿E (përmendju) kur Llukmani i tha birit të vet, duke e këshilluar: “O biri im, mos i bëj shirk (*idhujtari*) Allahut, pasi nuk ka dyshim se shirku (*idhujtaria*) është vërtet padrejtësi e madhe (që Allahu nuk e fal)!”﴾ (Lukman:13).

E kur është pyetur i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! –:

أي ذنب أعظم؟ قال: «أن تجعل لله نداً وهو خلقك»

“Cili është gjynahu më i madh? Tha: «*T’i bësh Allahut shirk* (të adhurosh dikë tjetër krahas Tij), *ndërkohë që* (vetëm) *Ai është që të ka krijuar.*» (Mutefekun alejhi)

## Pyetja e 2-të: Çfarë është shirku i madh?

**Përgjigjja:** Shirku i madh është kryerja i një adhurimi për dikë tjetër përveç Allahut, siç është lutja drejtuar dikujt tjetër përveç Tij, kërkimi i ndihmës prej të vdekurve apo kërkimi i ndihmës prej të gjallëve që nuk janë prezentë, siç Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا﴾ [النساء: ٣٦]

﴿...dhe adhurojeni (vetëm) Allahun dhe mos i bëni atij shirk (duke adhuruar krahas Tij) asgjë.﴾ (en-Nisa:36)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«من أكبر الكبائر: الشرك بالله»

«*Më e madhja e të mëdhave në mesin e gjyanaheve është shirku.*» (Buhariu)



### Pyetja e 3-të: Po në këtë kohë a ekziston idhujtaria?

**Përgjigjja:** Po, sigurisht! Ajo ekziston madje në forma dhe mënyra nga më të ndryshmet, në lidhje me këtë Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَمَا يُؤْمِنُ أَكْثَرُهُمْ بِاللَّهِ إِلَّا وَهُمْ مُشْرِكُونَ﴾ [يوسف: ١٠٦]

﴿**Dhe se shumica e tyre (njerëzve në tokë) nuk e besojnë Allahun ndryshe, veçse si idhujtarë (duke adhuruar krahas Tij dhe të tjerë)!**﴾ (Jusuf:106)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«لا تقوم الساعة حتى تلحق قبائل من أمتي بالمشركين وحتى تعبد الأوثان»

«**Nuk do të vijë Ora (fundi i botës), derisa disa fise të vendit tim të bashkohen me idhujtarët, dhe derisa të adhurojnë idhujt (me ta)!**» (Tirmidhiu: Sahih)



## Pyetja e 4-të: Cilat janë pasojat e shirkut të madh?

**Përgjigja:** Shirku i madh e nxjerr njeriun nga Islami dhe është shkak që ai (*që ka vdekur idhujtar*) të dënohet në zjarrin e përjetshëm të Xhehenemit. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ﴾ [المائدة: 72]

﴿ (Dijeni se) **ai që i bën shirk Allahut** (e konsideron dikë të barabartë me Të), **atij Allahu ia ka bërë haram Xhennetin dhe përfundimi i tij është Zjarri, dhe se për keqbërësit (idhujtarët) nuk do të ketë kush t'i ndihmojë!** ﴾ (el-Maide:72) Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«من لقي الله يشرك به شيئاً دخل النار»

«**Kush kthehet tek Allahu (vdes) duke i shoqëruar Atij dikë tjetër në adhurim, do të hyjnë në Zjarr.**» (Muslimi)





**Pyetja e 5-të: A i bëjnë dobi personit bamirësia dhe veprat e mira nëse ai i bën shirk (idhujtari) Allahut?**

**Përgjigja:** Jo, veprat e mira nuk i bëjnë asnjë dobi personit tek Allahu, nëse ai i bën shirk Allahut, duke besuar apo adhuruar dikë tjetër krahas Tij, bazuar në fjalën e Allahut i Cili ka thënë:

﴿وَلَوْ أَشْرَكُوا لَحَبِطَ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ﴾ [الأنعام: ٨٨]

﴿Në qoftë se ata do të kishin bërë idhujtari do t'u shkonte dëm çdo vepër (e mirë dhe çdo mirësi) tjetër që ata kanë bërë.﴾ (el-En'am:88)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«*Allahu i Madhëruar ka thënë: “Unë jam shumë më i Pasur se t’ia kem nevojën ndokujt. Prandaj, kush bën një vepër, duke më shoqëruar Mua (ortak) dikë tjetër, e kam lënë atë dhe shirkun (ortakërinë) e tij.*» (Muslimi)







**VEPRA QË  
E RREZIKOJNË  
BESIMIN**







**Pyetja e 1-rë: Cili është gjykimi në lidhje me magjinë?**

**Përgjigjja:** Magjia konsiderohet kufër (që të nxjerr nga Islami) siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَمَا كَفَرَ سُلَيْمَانُ وَلَكِنَّ الشَّيَاطِينَ كَفَرُوا يُعَلِّمُونَ النَّاسَ السِّحْرَ﴾ [البقرة: ١٠٢]

﴿E nuk pati bërë kufër Sulejmani (me bërjen magji), por ishin shejtanët ata që patën mohuar (duke bërë magji). Ata u mësojnë njerëzve magjinë.﴾ (el-Bekare:102)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«اجتنبوا السبع الموبقات: الشرك بالله، والسحر»

«Largohuni prej shtatë veprave shkatërrimtare (që të nxjerrin nga feja): Prej shirkut (idhujtarisë) ndaj Allahut dhe prej (mësimet dhe bërjes së) magjisë...»

**Pyetja e 2-të: A mund ta dijë dikush prej krijesave gajbin<sup>6</sup> (të fshehtën)?**

**Përgjigjja:** Jo, askush nuk mund të dijë gajbin përveç Allahut dhe përveç ndonjë të dërguari që vetë Allahu ka dashur t'ia shpallë diçka prej të fshehtave, ashtu siç Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿عَالِمُ الْغَيْبِ فَلَا يُظْهِرُ عَلَىٰ غَيْبِهِ أَحَدًا إِلَّا مَنِ ارْتَضَىٰ مِنْ رَسُولٍ﴾

[الجن: ۲۶-۲۷]

﴿**Vetëm Ai është Njohësi i gajbit (fshehtësive), dhe se gajbin (fshehtësitë) e Tij Ai nuk ia tregon askujt, përveç nëse është i kënaqur (dëshiron) t'ia tregojë (diçka prej tij) ndonjë të dërguari...**﴾ (el-Xhin:26-27)

Ndërsa i Dërguari i Allahut - Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«لا يعلم الغيب إلا الله»

«*Askush përveç Allahut nuk e di gajbin (fshehtësitë).*» (Taberaniu:Hasen)



<sup>6</sup> Me termin “gajb” nënkuptohet çdo gjë e fshehtë në lidhje me krijesat, duke përfshirë brendësitë, historitë, fillimin, fundin dhe të ardhmen e tyre, dhe këtë dije nuk e ka askush përveç Allahut.

**Pyetja e 3-të: Po fallxhorët apo parashikuesit e fatit a mund t'i besojmë në lidhje me gajbin (të fshहतat)?**

**Përgjigjja:** Jo, kurrsesi nuk duhet t'u besojmë atyre në lidhje me pretendimet e tyre që ata thonë, ashtu siç Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿قُلْ لَا يَعْلَمُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ الْغَيْبَ إِلَّا اللَّهُ وَمَا يَشْعُرُونَ أَيَّانَ يُبْعَثُونَ﴾

[النمل: ٦٥]

﴿**Thuaj: Askush, as në qiej dhe as në tokë, nuk e di gajbin (fshहतësitë) përveç Allahut, e madje ata (krijesat) nuk e dinë as se kur do të ringjallen!**﴾ (el-Neml:65)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«من أتى عرافاً أو كاهناً فصدق به بما يقول فقد كفر بما أنزل على محمد»

«**Kush shkton tek fallxhori apo tek parashikuesi i fatit dhe beson në ato që ai thotë, ai e ka mohuar atë që i ka zbritur Muhamedit.**» (Ahmedi: Sahih)



**Pyetja e 4-tërt: Nëse Allahu e ka caktuar se kush është i shpëtuar e kush jo, përse të mos e lëmë përpjekjen tonë e t'i qëndrojmë asaj që është caktuar?**

**Pëgjigjja:** Jo, ne nuk e lëmë përpjekjen, pasi ne nuk e dimë atë që Ai e ka caktuar, madje Ai na obligoi që të punojmë sipas asaj që Ai na e ka kërkuar, kështu që të punuarit asesi nuk duhet lënë, bazuar në fjalën e Tij ku thotë:

﴿فَأَمَّا مَنْ أَعْطَىٰ وَاتَّقَىٰ وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَىٰ فَسَنِيسِرُّهُ لَلْيُسْرَىٰ﴾ [الليل: ٥-٧]

﴿**E sa i përket atij që jep (sadaka) dhe ruhet (nga gjynahet), si dhe i beson sinqerisht Mirësisë (së ardhur prej Allahut - Shpalljes), Ne kemi për t'ia lehtësuar atij (rrugën) për tek e lehta.**﴾ (el-Lejl:5-7)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«اعملوا فكل ميسر لما خلق له»

«**Punoni, pasi secilit do t'i lehtësohet ajo (vepër) për të cilën është krijuar.**» (Buhariu dhe Muslimi).





## **Pyetja e 5-të: A lejohet vënia e byzylykëve apo e penjve për shërim?**

**Përgjigja:** Jo, vendosja e gjërave të tilla nuk është e lejuar, madje vendosja e tyre është e ndaluar, ngase të besuarit se diçka tjetër përveç Allahut pret fatkeqësi apo sjell mbarësi konsiderohet idhujtari, dhe Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَإِنْ يَمْسَسْكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ﴾ [الأنعام:17]

﴿Nëse Allahu të sprovon me ndonjë të keqe, askush përveç Tij nuk mund të ta largojë atë...﴾ (el-Enam:17)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«*Kush vendos ndonjë hajmali<sup>(7)</sup>, në të vërtetë ka bërë shirk (idhujtari).*» (Ahmedi:Sahih)




---

<sup>7</sup> Me “hajmali” konsiderohet diçka që njerëzit e paditur lidhin apo vënë në trupat, kafshët apo pronat e tyre, për t’u mbrojtur me to nga e keqja apo syri i keq.

## **Pyetja e 6-të: Cili është gjykimi i të punuarit me rregulla të cilat bien ndesh me Islamin?**

**Përgjigja:** Në rast se personi i konsideron ato ligje të lejuara apo mendon se ato rregulla janë më të mira se ligjet e Allahut, atëherë të punuarit me ato ligje të cilat i kundërvihen Islamin, konsiderohet mohim i Allahut, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ﴾ [المائدة: ٤٤]

﴿**E kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu (për shkak të refuzimit të tij), të tillët janë jobesimtarë.**﴾

(el-Maide:44)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«ومال تحكم أنتمهم بكتاب الله ويتخيروا مما أنزل الله جعل الله بأسهم بينهم»

*«...dhe për aq kohë sa udhëheqësit e tyre nuk do të gjykojnë me Librin e Allahut dhe preferojnë diçka tjetër nga ajo që ka zbritur Allahu, Allahu do të bëjë që armiqësia e tyre të jetë kundër njëri-tjetrit.»* (Ibn Maxheh: hasen).





# SHIRKU I VOGËL

(SHIRKU QË NUK TË

NXJERR NGA BESIMI)







### **Pyetja e 1-rë: Çfarë është shirku i vogël?**

**Përgjigjja:** Shirk i vogël është kur një adhurim nuk bëhet për të fituar kënaqësinë e Allahut, por për interesa vetjake, dhe mund të vijë në shumë forma. Më kryesorja prej tyre është **syefaqsia**. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا﴾  
[الكهف: ١١٠]

﴿E kush e shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira e përmirësuese dhe të mos e bashkojë në adhurim me Zotin e vet asnjë.﴾

(el-Kehf:110)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«إن أخوف ما أخاف عليكم الشرك الأصغر: الرياء»

«Ajo që unë ia kam frikën më tepër dhe më shqetëson në lidhje me ju, është shirku i vogël: syefaqsia.» (Ahmedi:Sahih)

Po ashtu, prej formave të shirkut të vogël është edhe shprehja:

**“Po të mos ishte Allahu edhe filani...”** duke bashkuar dikë tjetër me Allahun, apo shprehja: **“(U bë) siç deshi Allahu dhe deshe ti”**.

Ngase i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë :

«لاتقولوا ماشاء الله وشاء فلان، ولكن قولوا ماشاء الله ثم شاء فلان»

**«Mos thoni: “(U bë) si deshi Allahu dhe si deshi filani!” por thoni: “(U bë) si deshi Allahu dhe pastaj siç deshi filani!”**

» (Ebu Daudi: Sahih)



## Pyetja e 2-të: A lejohet betimi në emër të dikujt tjetër përveç Allahut?

**Përgjigjja:** Jo, as betimi në dikë tjetër përveç Allahut nuk lejohet, pasi betimi është madhërim dhe shenjtërim, dhe se krijesës nuk i takon të madhërojë dhe as shenjtërojë përveç Allahut asnjë dhe asgjë tjetër, bazuar në fjalën e Allahut:

﴿زَعَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُبْعَثُوا قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ﴾ [التغابن:7]

﴿**Jobsimtarët menduan se kurrë nuk kanë për t'u ringjallur. Thuaju (o i Dërguar): Sigurisht pasha Zotin tim, keni për t'u ringjallur...**﴾ (et-Tegabun:7)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«من حلف بغير الله فقد كفر أو أشرك»

«*Kush betohet në dikë tjetër përveç Allahut, ka bërë kufër ose shirk.*»<sup>(8)</sup> (Ahmedi: Sahih). Po ashtu ka thënë:

«من كان حالفاً فليحلف بالله أو ليصمت»

«*Kush dëshiron të betohet, le të betohet vetëm në Allahun ose le të heshtë.*» (Mutefekun alehi)



<sup>8</sup> Gjithashtu në një hadith tjetër thuhet se nëse dikush betohet pa dashje në dikë apo diçka tjetër përveç Allahut, të thotë pas kësaj: La ilahe ila'Allah dhe kjo do jetë kompnesim për të.







# TEUESULI DHE SHEFATI

(TË KËRKUARIT E AFRIMITETIT  
DHE NDËRMJETËSIMIT)







**Pyetja e 1-rë: A është e lejuar që të marrim ndërmjetës mes nesh dhe Allahut, që ata të përcjellin tek Allahu lutjet dhe duatë tona?**

**Përgjigja:** Jo, kurrsesi nuk është e lejuar që të marrim ndërmjetës mes nesh dhe Allahut që ata t'i përcjellin Allahut lutjet tona, ngase Allahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur dhe kërkon nga ne që t'i lutemi vetëm Atij pa asnjë ndërmjetës, ashtu siç ka thënë në Kuran:

﴿وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ﴾

[البقرة: ١٨٦]

﴿ **E nëse të pyesin robërit e Mi për Mua, (le ta dinë se) Unë jam afër. I përgjigjem lutësit kur ai më lutet.** ﴾

(el-Bekare:186)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«إنكم تدعون سميعا قريبا وهو معكم»

«**Ju po i luteni Atij që është Dëgjues, i Afërt, i Cili është me ju.**» pra, me Dijen dhe kujdesin e Tij. (Muslimi)

**Pyetja e 2-të: Po shefati (ndërmjetësimi) i Pejgamberit – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – për ne tek Allahu (Ditën e Gjykimit) përse kërkohet?**

**Përgjigjja:** Shefati (ndërmjetësimi) i të Dërguarit – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – për ne tek Allahu (Ditën e Gjykimit), kërkohet vetëm prej Allahut dhe leja për këtë do t'i jepet vetëm në Ditën e Gjykimit, ngase Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿قُلْ لِلَّهِ الشَّفَاعَةُ جَمِيعًا﴾ [الزمر: ٤٤]

﴿**Thuaj: I tërë shefati (leja për ndërmjetësim) i përket vetëm Allahut...**﴾ (ez-Zumer:44)

Ashtu siç i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – i mësonte sahabët që t'i luteshin Allahut për t'ia mundësuar atij lejen për shefat (ndërmjetësim) në Ditën e Gjykimit për ta, duke u thënë të thonin:

«اللهم اشفعه في»

«**O Allah bëje atë (Pejgamberin – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! -) ndërmjetësues për mua (në Ditën e Gjykimit)...**»  
(Tirmidhiu: Hasen-Sahih)

Madje i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – e ka specifikuar se ky ndërmjetësim për ta do të jetë në Ditën e Gjykimit, dhe ka thënë:

«وإني اختبأت دعوتي شفاعة لأمتي إلى يوم القامة فهي نائلة إن شاء الله من مات من أمتي لا يشرك بالله شيئاً»

**«...ndërsa unë lutjen time (të pakthyeshme) e kam ruajtur që të jetë shefati (ndërmjetësimi) për umetin tim në Ditën e Gjykimit. Dhe se ajo do të jetë e mundur in'shaAllah (Në dashtë Allahu!) për këdo që ka vdekur prej umetit tim, duke mos i shoqëruar Allahut ortak (duke i qenë i pastër nga idhujtaria).» (Muslimi)**



**Pyetja e 3-të: Atëherë çfarë kuptojmë me emërtimin e të Dërguarit të Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ‘ndërmjetës’?**

**Përgjigja:** Të qenët e të Dërguarit të Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ndërmjetës, është të qenët e tij përcjellës (*sqarues*) i shpalljes hyjnore, mes Allahut dhe robërve të Tij, siç e ka përmendur Allahu i Lartësuar kur thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ﴾ [المائدة: 67]

﴿**O i Dërguar, përcille atë që të është shpallur ty prej Zotit tënd.**﴾ (el-Maide:67)

Po ashtu i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – kur i pyeti sahabët në hytben e lamtumirës: “*A pranoni që ua kam përcjellë (atë që më është zbritur)?!*” dhe ata thanë: «*Po! Ne dëshmojmë se ti e ke përcjellë (fenë e Allahut).*» si përmbyllje e përgjigjes së tyre tha:

«اللهم فاشهد...»

«**O Allahu im! Dëshmo!**» (Muslimi)



**Pyetja e 4-tërt: A na lejohet ta mbivlerësojmë me lavdërime Pejgamberin** – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të -?

**Përgjigjja:** Edhe pse Pejgamberi – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – është njeriu më i shtrenjtë për ne, ai na e ka kërkuar që të tregohemi të matur dhe nuk na e ka lejuar që ta teprojmë me lavdërime ndaj tij, dhe se dashuria ndaj tij shprehet me ndjekjen e shembullit dhe të porosive të tij, madje edhe Allahu i Lartësuar e ka urdhëruar të thotë:

﴿قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُ الْكَافِرِينَ إِلهٌ وَاحِدٌ فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا﴾ [الكهف: ١١٠]

﴿Thuaj: Unë, në të vërtetë, nuk jam tjetër, veçse njeri ashtu si ju. (Përveçse) mua më është shpallur se Zoti i juaj që e meriton adhurimin është Zoti i Vetëm - Një (Allahu). Pra, kush beson se do të takohet me Krijuesin e vet, le të bëjë vepra përmirësuese dhe të mos i shoqërojë në adhurim Zotit të vet asnjë tjetër!﴾ (el-Kehf:110)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«لا تطروني كما أطرت النصارى ابن مريم، إنما أنا عبد، فقولوا: عبد الله ورسوله»

«Mos e teproni ndaj meje (me lëvdata) ashtu siç e tepruan të krishterët ndaj birit të Merjemes (Isait -alejhi selam-). Ngase unë jam një rob i Allahut, prandaj thoni për mua: Rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij.» (Buhariu)

Fjala “teprim” ka për qëllim të tepruarit në lëvdime.

## Pyetja e 5-të: Si duhet ta duam Allahun dhe të Dërguarin e Tij?

**Përgjigja:** Ne duhet ta duam Allahun dhe të Dërguarin e Tij, duke iu bindur mësimëve të tyre dhe duke i zbatuar porositë e tyre, ashtu siç Allahu ka thënë:

﴿قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ﴾ [آل عمران: 31]

﴿Thuaju (o i Dërguar): Nëse vërtet ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua që (t'ju mësoj si mund të arrini tek ajo që) t'ju dojë Allahu e t'jua falë juve gjynahet tuaja, pasi Allahu është Falës, Mëshirëplotë.﴾ (Al'i Imran:31)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

« لا يؤمن أحدكم حتى أكون أحب إليه من والده وولده والناس أجمعين »

«*Nuk ka besuar (me besim të plotë) askush prej jush derisa unë të jem më i dashur për të se prindi i tij, fëmijët e tij dhe mbarë njerëzit.*» (Mutefekun alejhi)





**Pyetja e 6-të: Po nëse kërkon nga të gjallët që të ndërmjetësojnë tek dikush me pozitë në jetën e kësaj bote, a lejohet?**

**Përgjigjja:** Po, na lejohet të kërkojmë nga të gjallët që të ndërmjetësojnë për çështjet e jetës së kësaj bote, siç është kërkimi i dikujt të ndërmjetësojë për pajtim etj. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿مَنْ يَشْفَعْ شَفَاعَةً حَسَنَةً يَكُنْ لَهُ نَصِيبٌ مِنْهَا وَمَنْ يَشْفَعْ شَفَاعَةً سَيِّئَةً يَكُنْ لَهُ كِفْلٌ مِنْهَا﴾ [النساء: 85]

﴿Kush ndërmjetëson për mirë, ai do ketë pjesën e vet të mirësisë, dhe kush ndërmjetëson për keq, ai do ketë pjesën e vet të së keqes.﴾ (en-Nisa:75)

Pra, "...pjesën e vet të barrës."

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«اشفعوا تؤجروا»

«*Bëhuni ndërmjetësues (për mirë) që të shpërbleheni!*» (Ebu Daudi: Sahih)



**Pyetja e 7-të: Me çfarë arrihet teuesuli (të kërkuarit afrimitet) me Allahun?**

**Përgjigja:** Teuesuli (të kërkuarit afrimitet me Allahun) është dy llojesh:

i lejuar, i ndaluar dhe teuesuli me nderin e Pejgamberit.

**a) Teuesuli i lejuar dhe i kërkuar** është ai që bëhet nëpërmjet:

– **Emrave dhe cilësive të Allahut, dhe veprave të mira**, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَلِلَّهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا﴾ [الأعراف: ١٨٠]

﴿**Allahut i përkasin emrat më të bukur, kështu që luteni me to.**﴾ (el-Earaf:180)

Si dhe ka thënë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَابْتَغُوا إِلَيْهِ الْوَسِيلَةَ وَجَاهِدُوا فِي سَبِيلِهِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ﴾ [المائدة: ٣٥]

﴿**O ju që besoni, frikësojuni Allahun dhe kërkonit teuesul (afrimitet) me Të.**﴾ (el-Maide:35) pra: “Kërkonit afrimitet tek Ai, me anë të bindjes ndaj Tij dhe me vepra të cilat e kënaqin.”<sup>(9)</sup>.

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – i lutej Allahut duke thënë:

«أَسْأَلُكَ بِكُلِّ اسْمٍ هُوَ لَكَ»

«**Unë të lutem Ty, me çdo emër që Ti ke...**» (Ahmedi:Sahih)

<sup>9</sup> E ka përmendur Ibn Kethiri, të cilin e ka marrë nga Katade.

Si dhe porosia që i la sahabiut që kërkoi të ishte shoqëruesi i tij në Xhennet, duke i thënë:

«أعني على نفسك بكثرة السجود»

«*Më ndihmo në të mirë të vetes tënde, duke bërë sa më shumë sexhde.*»(Muslimi).

Që do të thotë: “Duke falur namaz të shumtë!”, pasi vetëm kjo vepër është e dobishme për realizimin e kësaj kërkese.

**Teuesuli i lejuar** (*kërkimi afërsisë me Allahun*), po ashtu bëhet edhe nëpërmjet:

★ **Dashurisë tonë ndaj Allahut, ndaj Pejgamberit** – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – **dhe evlijave** (*besimtarëve të dashur të Allahut*).

– Për shtjellim më të detajuar dhe argumente më të shumta lidhur me këtë tematikë mund t’i referoheni studimit: «**et-Teuesul, ahkamuhu ue Enuu’uhu** (*Teuesuli, rregullat dhe llojet e tij*)» të Shejh Albanit.

– Argument, po ashtu, është edhe tregimi i Pejgamberit – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – në lidhje me tre udhëtarët të cilët ishin bllokuar në shpellë, ku secili bëri **teuesul** (*kërkoi afërsi*) me Allahun, nëpërmjet veprave të veta të mira që i kishte bërë më parë, derisa Allahu ua largoi fatkeqësinë (*duke ua hapur hyrjen e shpellës*).



### b) Teuesuli i ndaluar:

- Është ai që kërkohet me dua dhe lutje drejtuar të vdekurve, duke kërkuar prej tyre plotësimin e nevojave dhe largimin e fatkeqësive etj.

Ky lloj teuesuli konsiderohet shirk i madh (*që e nxjerr njeriun prej Islamit*), bazuar në fjalën e Allahut i Cili thotë:

﴿وَلَا تَدْعُ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَنْفَعُكَ وَلَا يَضُرُّكَ فَإِنْ فَعَلْتَ فَإِنَّكَ إِذَا مِنَ الظَّالِمِينَ﴾

[يونس: ١٠٦]

﴿Dhe mos lut në vend të Allahut asgjë që (nëse i lutesh) nuk të sjell dobi dhe (nëse nuk e adhuron) nuk të sjell as dëm. Dhe nëse ti e bën një gjë të tillë, atëherë do të jesh prej të padrejtëve (idhujtarëve)﴾ (Junus:106)  
Pra, do të jesh prej “idhujtarëve”, kjo pasi idhujtaria është padrejtësia më e madhe.

### Ndërsa teuesuli nëpërmjet nderit të Pejgamberit:

- Është ai teuesul (*kërkim afërsie me Allahun*) **nëpërmjet nderit të Pejgamberit** pas vdekjes së tij – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – duke thënë: “O Allah, pashë nderin e Muhamedit ma plotëso këtë...” ky është bidat në fe (*risi*), ngase një veprim të tillë nuk e ka bërë askush prej sahabëve.

Ndërsa rasti kur Umeri – Allahu qoftë i kënaqur prej tij! – i është lutur Allahut, duke thënë: “...për hatër të Abasit

**na lësho shi!**". (Pra, mos e pengoj shiun për shkak të gjynaheve tona, por nëse e lëshon për hatrin e tij, mos na privo edhe ne prej tij. sh.p), duhet ditur se kjo ka qenë kur **Abasi** (xhaxhait të Pejgamberit) ishte gjallë dhe ishte prezent duke u lutur për të njëjtën gjë aty me ta, dhe siç shihet **Umeri** nuk ka kërkuar **teuesul** (afritet me Allahun) nëpërmjet Pejgamberit që kishte vdekur – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!-, edhe pse ai ishte më i miri i njerëzimit dhe natyrisht edhe më i mirë se xhaxhai i vet **Abasi**.

Prandaj, siç e theksuam më lart, **teuesuli** duke kërkuar afërsi tek Allahu me të vdekurit qoftë edhe me Pejgamberin, nuk lejohet, pasi kjo mund të çojë në shirk të madh, sidomos nëse njeriu mendon se Allahu ka ndihmës dhe ndërmjetës ashtu siç kanë njerëzit me pozitë (*udhëheqësit apo mbretërit*), që nëpërmjet tyre të plotësojnë nevojat e tyre. Në këtë mënyrë ai e ka përngjasuar Krijuesin me krijesat dhe e ka prerë lidhjen e robit me Allahun.



## **Pyetja e 8-të: Po nëse u kërkon të gjallëve të bëjnë dua për ty a lejohet?**

**Përgjigja:** Po, lejohet që të kërkossh prej të gjallëve që të bëjnë dua për ty. Allahu e porositi të Dërguarin e Vet, sa ishte gjallë në mesin e njerëzve, duke i thënë:

﴿فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاسْتَغْفِرْ لِذَنبِكَ وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ﴾ [محمد: ١٩]

﴿Dije se nuk ka zot tjetër që e meriton adhurimin përveç Allahut dhe kërko falje për gabimet e tua, të besimtarëve dhe të besimtareve.﴾ (Muhamed:19)

Ashtu siç transmetohet në një hadith të saktë, të cilin e ka përmbledhur **Tirmidhiu**, se një i verbër shkoi tek i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – dhe i tha: «*Lutju Allahut që të më shërojë...*».





# RËNDËSIA E LUTJES

(LUTJA ËSHTË ADHURIM)









**Pyetja e 1-rë: A është lutja adhurim dhe kujt i duhet drejtuar ajo?!**

**Përgjigjja:** Po, lutja është adhurim dhe ajo i duhet drejtuar vetëm Allahut dhe askujt tjetër veç Tij. Në lidhje me këtë Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ﴾ [غافر: ٦٠]

﴿Dhe se Zoti juaj ka thënë: “Lutmuni (*vetëm*) Mua që Unë t’ju përgjigjem. Pa dyshim se ata që tregohen mendjemëdhenj, duke refuzuar adhurimin ndaj Meje, do të përfundojnë në Xhehenem të përçmuar.﴾ (Gafir:60) ku fjala “**të përçmuar**” nënkupton “të poshtëruar”.

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«الدعاء هو العبادة»

«**Pikërisht lutja është adhurimi!**» (Tra.Ahmedi dhe Tirmidhiu: Hasenun–Sahih).

## Pyetja e 2-të: A e dëgjojnë të vdekurit lutjen drejtuar atyre?

**Përgjigja:** Jo. Të vdekurit nuk mund ta dëgjojnë lutjen drejtuar atyre, ashtu siç ka thënë edhe Allahu i Lartësuar:

﴿إِنَّكَ لَا تَسْمَعُ الْمَوْتَى﴾ [النمل: ٨٠]

﴿Vërtet, ti nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë...﴾ (en-Neml:80)

Apo siç ka thënë në një tjetër ajet:

﴿وَمَا أَنْتَ بِمُسْمِعٍ مَن فِي الْقُبُورِ﴾ [فاطر: ٢٢]

﴿...dhe se ti nuk mund t'i bësh të dëgjojnë ata që janë në varre!﴾ (Fatir:22)



**Pyetja e 3-të: Cili është gjykimi lidhur me lutjen drejtuar të vdekurve apo atyre që nuk janë të pranishëm?**

**Përgjigjja:** Lutja drejtuar të vdekurve apo drejtuar të gjallëve që nuk janë të pranishëm, konsiderohet shirk i madh (*idhujtari që të nxjerr nga Islami*), nëse personi këmbëngul edhe pasi t'i bëhet e qartë se kjo vepër tek Allahu konsiderohet idhujtari, ashtu siç Allahu i Lartësuar ka thënë në Kuran:

﴿وَلَا تَدْعُ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَنْفَعُكَ وَلَا يَضُرُّكَ فَإِنْ فَعَلْتَ فَإِنَّكَ إِذَا مِنَ الظَّالِمِينَ﴾

[يونس: ١٠٦]

﴿Dhe mos lut tjetër në vend të Allahut, (*pasi*) askush (*përveç Allahut*) nuk është në gjendje të të sjelli dobi (*nëse Allahu nuk e do këtë*) dhe as nuk është në gjendje të të sjellë dëm (*nëse Allahu nuk e do këtë*). E nëse ti e bën këtë (*pra, lut dikë tjetër në vend të Allahut*), atëherë ti je prej të padrejtëve (*idhujtar*)﴾ (Junus:106) Pra, je bërë “idhujtar”, ngase lutja është adhurim dhe adhurimi i tjetërkujt përveç Allahut është idhujtari, dhe kjo është padrejtësi.

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«من مات وهو يدعو من دون الله ندأ دخل النار»

«Kush vdes (*pa u penduar*) duke lutur dikë tjetër përveç Allahut, do të hyjë në Zjarr.» (Buhariu)







ADHURIME TË TJERA  
QË I KUSHTOHEN  
VETËM ALLAHUT







**Pyetja e 1-rë: A mund të kërkojmë shpëtim prej të vdekurve apo prej atyre që nuk janë të pranishëm?**

**Përgjigjja:** Jo, kurrësi! Nuk lejohet kërkimi i shpëtimit prej askujt tjetër përveç Allahut, ashtu siç Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَالَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَا يَخْلُقُونَ شَيْئًا وَهُمْ يُخْلَقُونَ أَمْوَاتٌ غَيْرُ أَحْيَاءٍ، وَمَا يَشْعُرُونَ أَيَّانَ يُبْعَثُونَ﴾ [النحل: ٢٠-٢١]

﴿ (Le ta dinë) ata që lusin të tjerë përveç Allahut, se ata (të cilëve u luten në vend të Allahut) nuk mund të krijojnë asgjë, ndërkohë edhe ata vetë janë të krijuar. (Ishin) të vdekur dhe (tani janë) jo të gjallë, dhe madje as nuk e dinë se kur do të ringjallen. (en-Nahl:20-21)

Gjithashtu Ai ka thënë:

﴿إِذْ تَسْتَغِيثُونَ رَبَّكُمْ فَاسْتَجَابَ لَكُمْ﴾ [الأنفال:9]

﴿ (Kujtojeni) kur ju i kërkuat shpëtim Zotit tuaj e Ai ju është përgjigjur!﴾ (el-Enfal:9)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – lutej duke thënë:

«ياحي ياقيوم برحمتك استغيث»

«O i Gjallë e i Përjetshëm, në mëshirën Tënde kërkoj shpëtim!» (Tirmidhiu: Hasen)

## **Pyetja e 2-të: A është e lejuar që të kërkohet ndihmë prej dikujt tjetër përveç Allahut?**

**Përgjigja:** Jo, nuk është e lejuar. Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar që na tregon se si besimtarët duhet t'i luten Atij duke thënë:

﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ [الفاتحة: ٥]

﴿**Vetëm Ty (Allah) të adhurojmë e vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!**﴾ (el-Fatiha:5).

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«إِذَا سَأَلْتَ فَاسْأَلِ اللَّهَ، وَإِذَا اسْتَعْنَتْ فَاسْتَعْنِ بِاللَّهِ»

«**Kur të lutesh, lutju vetëm Allahut dhe kur të kërkosh ndihmë, kërkë ndihmë vetëm prej Allahut!**» (Tirmidhiu: Hasenun-Sahih)





### **Pyetja e 3-të: Po nëse u kërkohet ndihmë të gjallëve që janë të pranishëm?**

**Përgjigja:** Nëse të pranishmëve u kërkohet ndihmë për diçka të cilën ata kanë mundësi të të ndihmojnë, atëherë lejohet kërkimi i ndihmës prej tyre. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ﴾ [المائدة: ٢]

﴿E ju dihmoheni njëri-tjetrin në mirësi dhe në devotshmëri, dhe mos e ndihmoni njëri-tjetrin në gjynahe dhe armiqësi.﴾ (el-Maide:2)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«والله في عون العبد ما كان العبد في عون أخيه»

«Allahu është në ndihmë të robit, për aq kohë sa rob i është në ndihmë të vëllait të vet.» (Muslimi)



## **Pyetja e 4-të: A lejohet të bëhet kurban për dikë tjetër përveç Allahut?**

**Përgjigja:** Jo. Nuk lejohet që të bëhet kurban për asnjë tjetër përveç Allahut, dhe argumenti për këtë është fjala e Allahut:

﴿فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحَرْ﴾ [الكوثر: ٢]

﴿Dhe ti falu dhe bëj kurban vetëm për Zotin tënd﴾ (Keuther:2)

Fjala “*bëj kurban*” nënkupton “*ther në emër të Allahut, vetëm për Allahun*”.

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«*Allahu e ka mallkuar atë i cili ther për dikë tjetër përveç Allahut.*» (Muslimi)



**Pyetja e 5-të: A mund të bëjmë tavaf (rrotullohemi) rreth varreve (në formë adhurimi), me qëllim që të begatohemi me to?**

**Përgjigja:** Jo, ne nuk bëjmë tavaf (rrotullohemi) askund tjetër përveçse rreth Qabes, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿وَلْيَطَّوَّفُوا بِالْبَيْتِ الْعَتِيقِ﴾ [الحج: ٢٩]

﴿E ata le të bëjnë tavaf (rrotullim) vetëm rreth Shtëpisë së Lashtë (Qabes)!﴾ (el-Haxh:29)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! - ka thënë:

«من طاف بالبيت سبعاً وصلى ركعتين كان كعتق رقبة»

«*Kush bën tavaf (rrotullohet) rreth Qabes shtatë herë dhe pastaj fal dy rekate, i llogaritet sikur ka liruar një skllav.*»

(Ibn Maxheh: Sahih)



**Pyetja e 6-të: A lejohet të bësh nezër (t'ia kushtosh diçka) dikujt tjetri përveç Allahut?**

**Përgjigja:** Jo, nuk lejohet të bësh nezër (t'ia kushtosh diçka) dikujt tjetri përveç Allahut, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿إِذْ قَالَتِ امْرَأَتُ عِمْرَانَ رَبِّ إِنِّي نَذَرْتُ لَكَ مَا فِي بَطْنِي مُحَرَّرًا فَتَقَبَّلْ مِنِّي إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ﴾ [آل عمران: 35]

﴿ (tregoju) kur gruaja e Imranit pati thënë: “Zoti im! Këtë që unë e kam në barkun tim, po ta bëj nezër (po ta kushtoj) Ty, që të jetë vetëm në shërbimin Tënd...” ﴾ (Al'-Imran:35)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«من نذر أن يطيع الله فليطعه، ومن نذر أن يعصيه فلا يعصه»

«**Kush bën nezër (zotohet) për (të bërë diçka dhe ajo rezulton) bindje ndaj Allahut, duhet t'i bindet Atij (pra, le ta kryejë atë). Ndërsa kush bën nezër për (të bërë diçka dhe ajo rezulton) kundërshtim i Tij, të mos e kundërshtojë Atë (pra, ta lërë zotimin e bërë)!» (Buhariu)**





**KRITERET QË  
NJË PUNË TË PRANOHET  
TEK ALLAHU**







## **Pyetja e 1-rë: Cilat janë kriteret e një pune që ajo të pranohet tek Allahu?**

**Përgjigja:** Kriteret bazë që një vepër të jetë e pranuar tek Allahu janë tre: besimi, sinqeriteti dhe ndjekja e Pejgamberit (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem!).

**a) Besimi** në Allahun Një dhe të Vetëm, ose **veçimi** i Allahut në adhurim, duke i besuar dhe duke ia kushtuar adhurimin vetëm ndaj Tij, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar i Cili ka thënë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ كَانَتْ لَهُمْ جَنَّاتُ الْفِرْدَوْسِ نُزُلًا﴾ [الكهف:

[۱۰۷

﴿Vërtet ata që besuan dhe bënë vepra të mira e përmirësuese, vendqëndrimi i tyre do të jetë në xhenetet (kopshtet e larta) të Firdeusit!﴾ (el-Kehf:107)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«قل آمنتم بالله ثم استقم»

«Thuaj: “I kam besuar Allahut!” pastaj bëhu i qëndrueshëm në këtë!» (Muslimi)

**b) Singëriteti** në besim, në fjalë dhe në vepra, e që është bërja e veprës vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut, pa e përlyer atë me dyfytirësi apo me dëshirën për t'u dukur, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar i Cili thotë:

﴿فَاعْبُدِ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الدِّينَ﴾ [الزمر: ٢]

﴿...adhuroje Allahun me singëritet dhe kushtoja fenë vetëm Atij!﴾ (ez-Zumer:2)

**c) Ndjekja e shembullit të Pejgamberit të Allahut** – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ashtu siç na ka porositur Allahu i Lartësuar:

﴿وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ﴾ [الحشر: ٧]

﴿Atë që jua jep (porosi) i Dërguari merreni, dhe atë që jua ndalon hiqni dorë prej saj. E kijani frikën Allahut, se vërtet Allahu ndëshkon ashpër!﴾ (el-Hashr:7).  
Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«من عمل عملاً ليس عليه أمرنا فهو رد»

«*Kush vepron një vepër që nuk është nga veprat tona, ajo refuzohet!*» (Muslimi)

Fjala «...nuk është nga veprat tona...» nënkupton ato adhurime që nuk ka argument për to nga i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! –, por që janë vepra bidat, të shpikura dhe të sajura nga njerëzit.



Fjala «...*refuzohet*...» nënkupton se ai adhurim është i papranuar dhe në të njëjtën kohë është edhe gjynah, ngase personi që e bën atë ka sajuar një adhurim të cilin nuk e ka ligjësuar as Allahu dhe as i Dërguari i Tij - Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!-.







**SUNETI**

**DHE**

**BIDATI**







### **Pyetja e 1-rë: Ç'kuptojmë me bidat (sajesë) në fe?**

**Përgjigjja:** Bidati (*sajesa*) në fe, është të shtuarit e diçkaje në fe, e cila nuk është prej saj apo të hequrit e diçkaje që i përket asaj. Duke refuzuar sajusat që idhujtarët kishin bërë në emër të Allahut, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿أَمْ لَهُمْ شُرَكَاءُ شَرَعُوا لَهُمْ مِنَ الدِّينِ مَا لَمْ يَأْذَنْ بِهِ اللَّهُ وَلَوْلَا كَلِمَةُ الْفَصْلِ لَفُضِّيَ بَيْنَهُمْ وَإِنَّ الظَّالِمِينَ لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ﴾ [الشورى: ٢١]

﴿**A mos vallë ata kanë zota të tjerë (veç Meje), që u kanë sjellë atyre rregulla (të tjera) prej fesë (së Allahut), përkundër asaj që Allahu nuk ka dhënë leje për këtë? E po të mos kishte qenë Fjala Vendimtare (Dita e Gjykimit) me siguri që atyre do t'u ishte dhënë fund (për atë që ata bëjnë), mirëpo keqbërësit është duke i pritur një dënim i dhembshëm!**﴾ (esh-Shura:21)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«من أحدث في أمرنا هذا ما ليس منه فهو رد»

«**Kush sjell në çështjen (fenë) tonë diçka të re, e cila nuk është prej saj, ajo (tek Allahu do) i refuzohet.**» (Mutefekun alejhi)

Fjala:“**refuzohet**” ka kuptimin se ajo vepër nuk është e pranuar tek Allahu.

## Pyetja e 2-të: A e pranon feja atë që njihet si ‘bidat të mirë’?

**Përgjigja:** Jo, në fenë islame nuk ka diçka që njihet si bidat të mirë, pasi në Islam nuk ka hapsirë për plotësim, duke u bazuar në fjalën e Allahut që thotë:

﴿الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيْتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا﴾  
[المائدة: 3]

﴿Sot e kam plotësuar për ju Fenë tuaj dhe e kam përmbushur ndaj jush mirësinë Time, si dhe jam i kënaqur që feja juaj të jetë Islami.﴾ (el-Maide:3)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«كل بدعة ضلالة وكل ضلالة في النار»

«Çdo bidat (sajesë) është humbje (shtrembërim) dhe çdo humbje (devijim) të çon në Zjarr.» (Ahmedi dhe të tjerë: Sahih)



**Pyetja e 3-të: A ka në Islam diçka që njihet si ‘sunet të mirë’?**

**Përgjigja:** Po, në Islam ka **sunet** (*traditë me vepër*) të **mirë**, dhe ajo është ringjallja e një suneti të harruar ose bërja e një veprë që ka bazë në Islam, siç e ka përkthyer i Dërguari i Allahut:

«من سن في الإسلام سنة حسنة فله أجرها وأجر من عمل بها إلى يوم القيامة لا ينقص من أجورهم شيئا»

«*Kush ringjall në Islam një traditë të mirë (sunet), do të marrë shpërblimin e saj (veprës së bërë) dhe aq sa shpërblimi i veprës së atij që do e veprojë atë (vepër pas tij) deri në Ditën e Gjykimit, pa iu pakësuar asgjë nga shpërblimi.*» (Buhariu)









**PËRPPJEKJA NË MBROJTJE  
TË RRUGËS SË ALLAHUT**

(MIQËSIA PËR HIR TË ALLAHUT  
DHE GJYKIMI ME POROSITË E ALLAHUT)







**Pyetja e 1-rë: Cili është gjykimi në lidhje me përpjekjen në mbrojtje të Rrugës së Allahut?**

**Përgjigja:** Përpjekja dhe angazhimi në mbrojtje të Rrugës së Allahut është obligim, me pasuri, me shpirt, dhe me gjuhë. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَجَاهِدُوا بِأَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ، ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ﴾

[التوبة: ٤١]

﴿Dhe përpiquni në mbrojtje të Rrugës së Allahut me pasurinë dhe jetët tuaja, pasi kjo është më e mirë për ju nëse vërtetë e dini (se Allahu po ju mëson atë që është në të mirën tuaj).﴾ (et-Teube:41)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«جاهدوا المشركين بأموالكم وأنفسكم وألسنتكم»

«Përpiquni në mbrojtje të Rrugës së Allahut kundër idhujtarëve, me pasuritë tuaja, me jetët tuaja dhe me gjuhët tuaja!» (Ebu Daudi: Sahih)

## Pyetja e 2-të: Kush konsiderohet mik për besimtarët?

**Përgjigja:** Mik i sinqertë për besimtarët është vetëm ai që është besimtar dhe që ia ka frikën Zotit. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفَ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ الَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ﴾

[يونس: 62-63]

﴿**Vërtetë që miqtë e Allahut nuk do të kenë frikë (pasi do të jenë në mbrojtjen e Tij) dhe as mërzi (pasi ata do të jenë të kënaqur me shpërblimin e Tij). Janë ata që besuan dhe ruheshin nga gjynahet.**﴾ (Junus:62-63)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«إنما ولي الله وصالح المؤمنين»

«**Vërtet më i shtrenjti tek unë është Allahu dhe besimtarët e devotshëm!**» (Ahmedi: Sahih)



### **Pyetja e 3-të: Si ta kuptojmë miqësimin për hir të Allahut?**

**Përgjigja:** Miqësimi për hir të Allahut është dashuria dhe ndihmesa e besimtarëve për hir të Allahut. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَالْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ﴾ [التوبة: 71]

﴿**Besimtarët dhe besimtare** janë miq të njëri-tjetrit...﴾ (et-Teube:71)

Po ashtu i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«المؤمن للمؤمن كالبنيان يشد بعضه بعضاً»

«*Besimtari për besimtarin është si një ndërtesë, ku njëra pjesë e përforcon pjesën tjetër.*» (Muslimi)



## **Pyetja e 4-tërt: A lejohet miqësimi dhe ndihma e jobesimtarëve kundër besimtarëve?**

**Përgjigja:** Jo, asesi nuk lejohet miqësimi i jobesimtarëve dhe ndihma e tyre kundër muslimanëve, dhe për këtë Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِنْكُمْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ﴾ [التوبة: ٢٣]

﴿E kush prej jush kërkon miqësi me ta (në kohë luftime), të tillët janë keqbërës.﴾ (et-Teube:23)

Ndërsa argument nga i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! - në lidhje me këtë kemi fjalën e tij:

«إن آل بني فلان ليسوا بأوليائي»

«Vërtet familja e fisit filan nuk janë miqtë e mi.» (Ahmedi: Sahih)



## **Pyetja e 5-të: Me rregullat e kujt duhet ta jetojnë jetën muslimanët?**

**Përgjigjja:** Muslimanët duhet të jetojnë jetën me ligjet dhe porositë e Allahut të zbritura në Kuran dhe me porositë e Pejgamberit – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!- të ardhura në sunetit e saktë. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَأَنِ احْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ﴾ [المائدة: 49]

﴿Dhe gjyko mes tyre me atë që të ka zbritur Allahu...﴾ (el-Maide:49)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – lutej duke thënë:

«عَالِمِ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ أَنْتَ تَحْكُمُ بَيْنَ عِبَادِكَ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ»

«(O Allah) **Ti je Njohësi i të fshehtës dhe i të dukshmes. Ti je Ai që gjykon mes robërve të Tu në lidhje me mosmarrëveshjet e tyre...**» (Muslimi)









**TË PUNUARIT  
SIPAS KURANIT  
DHE SUNETIT**







### **Pyetja e 1-rë: Përse e ka zbritur Allahu Kuranin?**

**Përgjigja:** Allahu i Madhëruar e zbriti Kuranin që të studiohet dhe të vihen në zbatim porositë që gjenden në të. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿اتَّبِعُوا مَا أَنْزَلَ إِلَيْنَا مِنْ رَبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ﴾ [الأعراف: ٣]

﴿Ndiqeni atë që ju është zbritur prej Zotit tuaj dhe mos i ndiqni në vend të Tij ata që ju i mendoni se janë miqtë tuaj.﴾ (el-Earaf:3)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«اقرأوا القرآن واعملوا به، ولا تجفوا عنه، ولا تغلوا فيه، ولا تأكلوا به، ولا تستكثروا به»

*«Lexojeni Kuranin, zbatojini dispozitat e tij, mos e lini atë pas dore, mos i kaloni kufijtë në të, mos nxirrni fitime prej tij dhe mos e shtoni pasurinë me të!»* (Ahmedi: Sahih)

## Pyetja e 2-të: Sa i rëndësishëm është zbatimi i haditheve të sakta?

**Përgjigja:** Të zbatuarit e porosive të ardhura në hadithet e sakta është **vaxhib** (*obligim*), bazuar në Fjalën e Allahut që thotë:

﴿وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ، إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ﴾ [الحشر:7]

﴿**Atë që jua jep (porosi) i Dërguari merreni (dhe zbatoheni), dhe atë që jua ndalon, hiqni dorë prej saj, dhe frikësojuni Allahut, se vërtet Allahu e ka ndëshkimin e ashpër.**﴾ (el-Hashr:7)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«عليكم بسنتي وسنة الخلفاء الراشدين المهديين من بعدي، تمسكوا بها»

«**Përkushtojuni sunetit tim (rrugës profetike) dhe sunetit të (trashëguar prej) kalifëve (zëvendësve) të mi të udhëzuar dhe të drejtë pas meje! Kapuni për të me (kapje që nuk rrëshqet, si me) dhëmballë...**» (Ahmedi: Sahih)



### **Pyetja e 3-të: A është e mjaftueshme të marrim për bazë vetëm Kuranin pa i kushtuar rëndësi hadithit?**

**Përgjigja:** Jo, nuk është e mjaftueshme që të bazohemi vetëm në Kuran dhe të lihet mënjanë hadithi, pasi rëndësinë e sunetit e ka sqaruar vetë Allahu i Lartësuar duke thënë:

﴿وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ﴾ [النحل: ٤٤]

﴿...dhe poashtu Ne ta zbritëm ty (bashkë me Kuranin edhe) **Përkujtimin** (Sunetin profetik), (në mënyrë) që t'ua shpjegosh njerëzve (me të) atë që (tashmë) u zbriti (nga Kurani), dhe ndoshta (nga kjo) do të thellohen.﴾ (en-Nahl:44)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«ألا وإني أوتيت القرآن ومثله معه»

«**A nuk** (e keni vënë re se) **më është dhënë mua Kurani dhe diçka e ngjashme me të** (pra, suneti profetik)?» (Ebu Daudi e të tjerë: Sahih)



**Pyetja e 4-tërt: A lejohet t'i japim përparësi fjalës së dikujt tjetri në vend të fjalës së Allahut dhe fjalës së të Dërguarit** –Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! –?

**Përgjigjja:** Jo, nuk lejohet që t'i jepet përparësi fjalës së dikujt tjetri në vend të fjalës së Allahut dhe fjalës së të Dërguarit të Tij – sal-lAllahu alejhi ve sel-lem!-. Argumenti për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar ku thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقْدِمُوا يَدَيِ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ﴾ [الحجرات: 1]

﴿O ju që keni besuar! Mos jepni mendime para (se të konsultoheni me fjalët dhe porosinë e) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe frikësojuni Allahut, se vërtet Allahu është Dëgjues (i asaj që thoni), i Gjithëdijshëm (për pasojat).﴾ (el-Huxhurat:1)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«لا طاعة لمخلوق في معصية الخالق»

«Nuk tregohet bindje ndaj krijesës duke kundërshtuar *Krijuesin*.» (Taberanij: Sahih)

Si dhe thënia e **Ibn Abasit** – Allahu qoftë i kënaqur prej tij! – drejtuar atyre që u jepnin përparësi fjalëve të njerëzve përpara fjalëve të Pejgamberit – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! - : «(Mjerë për ju) **Kam frikë se mbi ju do të bien gurë nga qielli. Unë them: “Ka thënë i Dërguari i Allahut...”**, **ju më thoni: “Ka thënë Ebu Bekri...dhe ka thënë Umeri...”!!!**»

## Pyetja e 5-të: Çfarë të bëjmë nëse ka mosmarrëveshje mes nesh?

**Përgjigja:** Të kthehemi tek Libri i Allahut dhe suneti i saktë profetik, ashtu siç na ka porositur edhe Allahu i Lartësuar në Kuran:

﴿ فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ  
الْآخِرِ، ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا ﴾ [النساء: ٥٩]

﴿...e nëse keni mosmarrëveshje në lidhje me diçka, atëherë konsultojeni atë me atë që ka thënë Allahu dhe i Dërguari i Tij, nëse vërtet e besoni Allahun dhe Ditën e Gjykimit. Kjo është më e mirë (për paanësi) dhe shpjegimi më i mirë (për të mos bërë gabime). ﴾ (en-Nisa:59)

Ndërsa i Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! – ka thënë:

«عليكم بسنتي وسنة الخلفاء الراشدين المهديين من بعدي، تمسكوا بها»

«**Përkushtojuni sunetit tim dhe sunetit të** (trashëguar prej) **kalifëve** (zëvendësve) **të mi të drejtë dhe të udhëzuar pas meje!** **Kapuni për të me** (kapje që nuk rrëshqet, si me) **dhëmballë...**»

(Ahmedi: Sahih).



## Pyetja e 6-të: Kur do të ngrihen muslimanët?

**Përgjigjja:** Muslimanët do të ngrihen vetëm kur t'i kthehen leximit, kuptimit dhe zbatimit të Librit të Zotit të tyre që Ai ua ka zbritur ta zbatojnë atë në dritën e sunetit të Profetit të tyre – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! –, kur të angazhohen në përhapjen e teuhidit dhe të distancohen tërësisht nga shirku, me besimin se vetëm Allahu e meriton adhurimin dhe madhërimin, si dhe kur ata të jenë të gatshëm t'u vijnë në ndihmë njerëzve po në dobi të njerëzimit, me përfitimin e zemrave dhe me përhapjen e drejtësisë, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ مِنْ بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا يَعْبُدُونَنِي لَا يُشْرِكُونَ بِي شَيْئًا وَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ فَأُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ﴾ [النور: ٥٥]

﴿Allahu u ka premtuar atyre që besojnë prej jush dhe bëjnë vepra të dobishme e përmirësuese, se ka për t'i bërë udhëheqës në tokë, ashtu siç i pati bërë udhëheqës ata që ishin para tyre, si dhe fesë së tyre, të cilën ua zgjodhi dhe është i kënaqur me të, Ai do t'i japë autoritet. Dhe (kështu) frikën (që ata kishin më parë nga persekutimet e shtypja) Ai ka për t'ua zëvendësuar me gjendje sigurie, (me qëllim që) të më adhurojnë vetëm Mua dhe të mos më bëjnë Mua ortakëri me asgjë. E kush pas (realizimit të) kësaj mohon, pikërisht të tillët janë keqbërësit.﴾ (en-Nur:55)





ÇFARË DUHET TË  
THEMI QË TË NA  
PRANOHET LUTJA?







I Dërguari i Allahut – Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të! –  
ka thënë:

«ما أَصَابَ أَحَدًا قَطُّ هَمٌّ وَلَا حَزَنٌ فَقَالَ: اللَّهُمَّ إِنِّي عَبْدُكَ بن عبدك بن أمتِكَ،  
ناصيتي بيديك، ماضٍ في حُكْمِكَ، عَدَلٌ في قِضَاؤِكَ، أَسْأَلُكَ بِكُلِّ اسْمٍ هُوَ لَكَ،  
سَمَّيْتَهُ بِهِ نَفْسَكَ، أَوْ عَلَّمْتَهُ أَحَدًا مِنْ خَلْقِكَ، أَوْ أَنْزَلْتَهُ فِي كِتَابِكَ، أَوْ اسْتَأْثَرْتَهُ  
بِهِ فِي عِلْمِ الْغَيْبِ عِنْدَكَ، أَنْ تَجْعَلَ الْقُرْآنَ رَبِيعَ قَلْبِي، وَنُورَ صَدْرِي، وَجَلَاءَ حَزَنِي،  
وَذَهَابَ هَمِّي، إِلَّا أَذْهَبَ اللَّهُ هَمَّهُ وَحَزَنَهُ، وَأَبْدَلَهُ مَكَانَهُ فَرَجًا»

«Nuk ka preokupim apo mërzi që mund t'i bjerë  
dikujt e ai të thotë:

“O Allah, unë jam rob i yt, biri i robit tënd, biri  
i robëreshës tënde. Balli im është në Dorën Tënde,  
gjykimi Yt mbi mua tashmë është i kryer, caktimi Yt  
ndaj meje është i drejtë. Të lutem, duke kërkuar prej  
Teje, me çdo emër që Ti ke, dhe me të cilin Ti e ke  
emërtuar Vetën Tënde, apo ia ke mësuar atë dikujt  
prej krijesave të Tua, apo e ke zbritur atë në Librin  
Tënd, apo që Ti e ke veçuar duke e mbajtur atë në  
dijen e Fshehtë tek Ti, që ta bësh Kuranin pranverën  
e zemrës time, dritën e gjoksit tim, heqjen e mërzisë  
time dhe largimin e preokupimit tim!” veçse Allahu

**ka për t'ia larguar atij preokupimin dhe mërzinë, si dhe ka për t'ia zëvendësuar ato me gëzim dhe lumturi.» (Ahmedi: Sahih)**

*Falënderimi i përket Allahut, Zotit të botëve, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin, familjen dhe shokët e tij deri në Ditën e Gjykimit!*





## PËRMBAJTJA

<i>Parathënie</i>	3
<i>Fjala e përkthyesit</i>	5
Teuhidi - Veçimi i Allahut në adhurim dhe rëndësia e tij	15
Shirku i madh (Idhujtaria që të nxjerr nga besimi)	27
Vepra që e rrezikojnë besimin	35
Shirku i vogël (shirku që nuk të nxjerr nga besimi)	43
Teuesuli dhe shefati (të kërkuarit e afrimitetit dhe ndërmjetësimit)	49
Rëndësia e lutjes (Lutja është adhurim)	
Adhurime të tjera që i kushtohen vetëm Allahut	69
Kriteret që një punë të pranohet tek Allahu	77
Suneti dhe bidati	83
Përpjekja në mbrojtje të Rrugës së Allahut (Miqësia për hir të Allahut dhe gjykimi me porosinë e Allahut)	89
Të punuarit sipas Kuranit dhe Sunetit	97
Çfarë duhet të themi që të na pranohet lutja?	105